Intervistë me Gjekë Marinaj, poeti që jeton në SHBA

Poezia Kosovare, aq dinamike, aq interesante, aq e ndjeshme...

Energjia e brendshme, freskia tematike, thellësia e ndjenjës dhe e mendimit, tradita e shquar e bashkë-jetimit të shqiptarëve me vargun e bëjnë poezinë shqipe të parafytyrohet para botës sa antike aq edhe të re, sa të ashpër aq edhe të ndjeshme, sa lokale aq edhe mbarë-njerëzore

Mirjeta SELIMI

Gjekë Marinaj (1965) as në ëndrrën më të bukur të fëmijërisë s'ka mundur ta përjetojë kënaqësinë e ofruar nga realiteti i tanishëm që të jetë dikush gjatë jetës së tij në këtë botë.

Në vitin 1990, në njërin cep të gazetës letrare "Drita" që ka qenë organ i Lidhjes së Shkrimtarëve të Shqipërisë, një poezi fare e shkurtër me titull "Kuajt", do të tërheqë vëmendjen e shumë lexuesve dhe do të bëjë bujë të jashtëzakonshmë sa që tirazhi i madh i gazetës do të shkojë brenda ditës. Shkrimtari dhe njëri prej njerëzve kyç te "Drita", Nasi Lera dikund më vonë do të tregojë për reagimin e pushtetit komunist të asaj bote në Shqipëri. "Të nesërmen më telefonuan nga lart dhe më thanë se çfarë kishim bërë me atë poezi që njerëzit i quante kuaj", do të vë në pah Lera. Fill pas kësaj, njëzet e pesë vjeçarit të asaj kohe, të lindur në fshatin Brrut të Malsisë së Madhe në Shqipëri, do t'i duhet të durojë vetë "shqelma" nga "Kuajt". Do të detyrohet të arratiset nga Shqipëria, të kalojë tinëz në territorin e ish-Jugosllavisë dhe të vendoset për disa ditë në Beograd. Atje ambasadori amerkan do ta pyet: "A ke prova se je kundër komunizmit?". Një përkthyes do t'ia japë atij poezinë "Kuajt", mandej fjalët e para dhe të fundit të amerikanit të vjetër do të jenë: "Paç fat në Amerikë, bir". Kjo është në vija të trasha historia e kapërcimit të Atlantikut me "Kuajt" që Gjekë Marinajn do ta vendosë në Richardson të Tekxasit në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Atje Marinaj do të punojë, shkruaj, përkthejë etj., por nuk do ta harrojë asnjëherë atdheun dhe përherë do të jetë mirënjohës ndaj tij.

Zëri: - Ka pesëmbëdhjetë vjet që jetoni, punoni dhe krijoni në SHBA, vendin që sot realisht paraqet "El dorado" në shumë sfera po qe se krahasohet me të tjerat vende. Çfarë kushtesh i ofrohen një krijuesi në SHBA?

Gjekë Marinaj: - Amerika ofron kapacitetin për të gjithë ata që kanë një edukim të arsyeshëm të fitojnë paratë e mjaftueshme për të mbijetuar. Një nga gjërat që krijuesit mund të arrijnë në Amerikë është jetesa, ne mund të jetojmë. Amerika, në të njëjtën kohë ofron një numër të madh artdashësish, një kulturë gjigante me dhjetëra miliona njerëzish të shkolluar. Ajo ofron një mundësi të jashtëzakonshme për të mësuar nga dhe për të hyrë tek diversiteti social, ideor dhe teknologjikoshkencor. Nuk është sekret që Amerika përbëhet nga një popullatë e fragmentuar në mijëra drejtime me interesa nga më të larmishmet, gjë që e shtynë letërsinë dhe artin në një korridor më të ngushtë të nevojave dhe të dëshirave të përgjithshme që kanë. Kështu krijuesit janë të detyruar të krijojnë botën e vet, ta drejtojnë, promovojnë dhe ta mbrojnë atë. Kjo më jep mundësinë të shtoj diçka edhe rreth anës tjetër të medaljes së favorizimeve që sapo përmenda. Krijuesi duhet të besojë në vetvete, të ketë kurajë të jetojë si një poet, artist apo shkrimtar në Amerikë.

Zëri: - Ku e sheh poezinë shqiptare në raport me poezinë që krijohet sot në vendet e tjera?

Gjekë Marinaj: - Energjia e brendshme, freskia tematike, thellësia e ndjenjës dhe e mendimit, tradita e shquar e bashkë-jetimit të shqiptarëve me vargun e bëjnë poezinë shqipe të parafytyrohet para botës sa antike aq edhe të re, sa të ashpër aq edhe të ndjeshme, sa lokale aq edhe mbarë-njerëzore. Shumica e akademikëve do të binin dakord se një gjë e tillë nuk mund të thuhet për poezinë e shumë vendeve të tjera.

Zëri: - A mund të thuhet e njëjta gjë edhe për poezinë që shqiptarët e Amerikës e krijojnë sot atje?

Gjekë Marinaj: - Kjo pyetje po më shtyn të përqendrohem tek koncepti i vetëbesimit në raport me realitetin. Pikërisht ky koncept, pra raporti i

Gjekë Marinaj

vetëbesimit kundrejt aftësive për të prodhuar një krijimtari konkurruese është problemi kryesor që krijuesit shqiptar në Amerikë hasin në punën e tyre. Ndoshta tre apo katër (të tregohem shumë zëmërbardhë) poetë shqiptar në Amerikë mund të arrijnë nivelin e mesëm midis poezisë serioze bashkëkohore amerikane. Një pjesë e mirë krijojnë një poezi relativisht të pranueshme që premton, por kanë ngelur në orbitën e tyre, orbitë që nuk mund të konsiderohet konkurruese me poezinë më të mirë amerikane. Pjesa që mbetët, për fat të keq, janë të gatshëm të sakrifikojnë nga gjërat më të rëndësishme të jetës së tyre për të bindur dikë për ta përkthyer krijimtarinë e tyre në anglisht, me dëshirën për të marrë pjesë në "panairin" e letërsisë së "artë" amerikane. Por e bëjnë këtë ose duke mos i kuptuar ose duke i injoruar pasojat personale dhe kombëtare që vijnë nga paraqitja në këtë "panair ari" me "fool's gold" (një metal vezullues që vetëm duket si ar, i cili i ka bërë gjeologët ta quajnë "ari i budallenjëve"). Kjo ndodh, për mendimin tim, se ata nuk i kanë pasur mundësitë të studiojnë artin e poezisë as në universitetet amerikane as në ato shqiptare. Si pasojë nuk e kuptojnë se poezia nuk është thjesht një varg fjalësh të palosura njëra mbi tjetrën, ashtu siç vijnë nga mendja apo nga shqetësimi që kanë. Ata paraqiten aq injorantë në zanatin e poezisë sa ç'jam unë, midis të tjerash, në zanatin e mekanikut të automjeteve, megjithëse e di se një veturë duhet të ketë rrota, timon, motor etj., ajo nuk ecën dot vetëm nëse unë nga dëshira për të qenë mekanik, i palosë pjesët e saj njëra mbi tjetrën si të ma merr mendja. Ajo që shoh si problem me ne krijuesit shqiptar në Amerikë është ngutja për të treguar vlerat individuale, jo ato kombëtare, para botës letrare të Amerikës dhe më gjerë.

Zëri: - Kush shkruan poezi në Shqipëri që mund të jetë pjesë e një antologjie botërore?

Gjekë Marinaj: - Nëse antologjia do të përbëhej nga poetët më të mirë të botës, jo nga poetët më të mirë të çdo vendi, sepse Shqipëria, si çdo vend tjetër, ka një numër të madh poetësh të shkëlqyer, mendoj se Agron Tufa do e meritonte të ishte pjesë e asaj antologjie.

Zëri: - Cili është mendimi i juaj për poezinë që krijohet në Kosovë dhe a është ndonjë autor për të cilin keni respekt?

Gjekë Marinaj: - Pjesa e dytë e kësaj pyetje, si dhe pyetja para kësaj, janë pyetje të vështira për këdo që flet me përgjegjësi profesionale dhe dinjitet njerëzor. Këto soj pyetjesh janë të përpiluara që i intervistuari të tregohet i pasaktë në përgjigjet e tij. Por ngaqë të gjithë gazetarët bëjnë pyetje të tilla, po të përgjigjem. Poezia Kosovare mund të gjykohet kryesisht në dy mënyra. Ajo mund të shihet si pjesë e historisë dhe e kulturës së popullit të Kosovës. Si e tillë ajo meriton të studiohet në thellësi me përqendrim në shumëllojshmërinë e saj tematike, estetike, etike dhe teknikoletrare-artistike. Ajo mund të ndjehet, gjithashtu, si produkt i mendjeve të ndritura, ku studiuesit, për ta shijuar plotësisht atë, duhet të përqendrohen në punimet individuale dhe në intensitetin artistik të poetëve të mëdhenj kosovar. Natyrisht, do të ishte mirë të studiohet në të dyja mënyrat njëherësh, por një gjë e tillë mund të arrihet vetëm në mënyrë sistematike shkollore, gjë e cila, automatikisht e eliminon mundësinë për të gjithë dashamirësit apo të interesuarit në poezinë kosovare. Pra poezia Kosovare është aq dinamike, aq interesante, aq e ndjeshme, aq përfaqësuese e kulturës dhe e vlerave të popullit të saj dhe aq cilësore sa çdo poezi e vendeve të tjera të botës. Ndër shkrimtarët që dua më shumë nga letërsia kosovare janë Agim Vinca, Rrahman Dedaj, Sabri Hamiti, Din Mehmeti, Ali Podrimja, Azem Shkreli etj. Por poeti që kam më për zemër nga të gjithë poetët është Eqrem Basha.

Zëri: - Gjendja katastrofale e lexueshmërisë a s'është tregues se kanë ndërruar kohërat dhe se sot bota bën edhe pa poezi?

Gjekë Marinaj: - Çfarë do të bënim pa poezinë? Unë mendoj se të jetosh pa poezi është njësoj si të jetosh pa pjesën fizike të gjuhës, pa të cilën do të humbnim efektin e shijes. Me humbjen e efektit të shijes do të humbnim interesin për specialitetet e ndryshme, pra do të mjaftoheshim me paraqitjen e jashtme të gjërave, me përkufizimin e të tjerëve se çfarë është e ëmbla, e tharta, njelmësia etj. Eliminimi i poezisë do i ngushtonte pa masë specifikimet që na ndajnë nga kafshët. Pa poezinë komunikimi njerëzor do të ndahej në një numër të madh kodesh primitive, kode që do e tjetërsonin njeriun deri në humbjen e identitetit.

Zëri: - Dikur e patët përfunduar kursin për të qenë gazetar, por më i suksesshëm jeni treguar duke e përdorur gjuhën e poezisë. Çka s'mundet ta thotë Gjekë Marinaj gazetar e thotë Gjekë Marinaj poet, apo ku qëndrojnë arsyet e këtyre ndryshimeve tek ju?

Gjekë Marinaj: Kur shkruaj si gazetar e nganjëherë si kritik letrar, shkruaj si një qytetar, si një njeri me një edukim njerëzor dhe shkollor të konsiderueshëm, si një human, ku shprehi opinionin tim personal. Si të thuash, shprehi bindjet e mija për jetën që jetoj si një njeri i zakonshëm, si një njeri i përditshëm… Por kur shkruaj si një poet, shkruaj i shtyrë apo i frymëzuar nga labirinthet më të fshehta të shpirtit tim në veçanti, të cilat mendoj se janë edhe gjërat më përfaqësuese të shpirtit të njerëzimit në përgjithësi. Kur shkruaj poezi jam i sigurt se nuk mbështes vetëm njërën anë të çështjes, jam i sigurt se nuk e tradhtoj ndjenjën e pastër, ekuilibrin shpirtëror, gjykimin tim më të drejtë në mbështetje të asaj që mendoj se është e arsyeshme, e ndershme, e drejtë. Pra nëse si gazetar edhe mund të bëj një gabim të keq për një arsye të mirë, në poezi etika e asaj që është e mirë kundrejt asaj që është e keqe i humbet vetitë gjatë filtrimit në thellësinë e shpirtit, duke kaluar një kohë relativisht të vogël në procesin e të menduarit para se të hidhet në fletën e bardhë. Poezia shpesh është pjesë e qenies së papërpunuar të poetit. Kur shkruaj si poet, mendoj se vetëm në raste shumë, shumë të rralla mund të jem gabim. Në kontrast, kur shkruaj si gazetar apo si kritik letrar mund të jem gati gjysmën e kohës i gabuar në ato që them. Ndoshta këtu e fiton epërsinë suksesi im si poet ndaj atij si gazetar.

Zëri: - Së fundi, çfarë mund të presim të lexojmë nga krijimtaria juaj e pabotuar deri tani?

Gjekë Marinaj: - Kam përfunduar një libër me vizione letrare. Gjithashtu kam gati një libër me koncept gazetaresk, pra artikuj, reportazhe, ese… Librin e tretë me poezi në shqip e kam në përfundim e sipër. Kam të përfunduar dhe gati për botim një libër me poezi në anglisht. Po në anglisht, kam edhe një libër me ese mbi letërsinë dhe artin e krijuesve të huaj, nga vende dhe kohë të ndryshme, që është pothuajse i kompletuar. ■

Filozofi: Leshek Kolakovski, mendimtar i madh polak

Nuk i dimë akoma përgjigjet në dilemat kryesore të jetës njerëzore

Është e vërtetë që mendimtarët e mëdhenj janë edhe autorë të gabimeve më të mëdha. - Me siguri që janë të bashkëlindura me ne gatishmëria për agresion, për dhunë, dhe afërsia me dhunën.. - Të ashtuquajturat vlera në botën njerëzore janë në raporte të vazhdueshme konflikti dhe kështu do të jetë gjithnjë

Leshek Kolakovski (1927), vlen sot për njërin prej mendimtarëve më të shquar bashkëkohor. Ka ligjëruar në universitetet më të njohura botërore dhe është autor i një morie librash të njohura.

Në vazhdim po sjellim njërën prej bisedave të tij më aktuale.

**** Çka do të thotë të jesh sot filozof? Si e shihni ju, si njeri prej filozofëve më të mëdhenj të gjallë rolin dhe vendin e filozofit dhe të filozofisë në Botën e sotme së cilës prore i kanoset shpërthimi?***

Kolakovski: Sa e di unë, nuk ka më filozof të madh të gjallë. Kjo, megjithatë, nuk ka edhe shumë rëndësi. Ne kemi trashëguar prej mendimtarëve të mëdhenj të së kaluarës shumë pyetje të cilat akoma na interesojnë. Tutje ne diskutojmë dhe shtyhemi çka është reale e çka jo, çka është e mira e çka e keqja, çka është e vërteta dhe a është Bota jonë një dukje e Botës tjetër.

**** Para disa vitesh, Papa Gjon Pali II theksoi që filozofitë e shekullit XX kanë humbur atraktivitetin e tyre dhe që koha e tyre, në fakt, ka skaduar...***

Kolakovski: Nuk më kujtohet konteksti i fjalëve të Papës. Filozofia e shekulit XX përmes gjuhëve të ndryshme është përpjekur të përgjigjet në pyetjet e njëjta. Disa prej këtyre gjuhëve, me gjasë, do të harrohen, të tjerat do të mbijetojnë, por është akoma herët të dimë se çfarë do të ndodhë me to.

**** A ka pasur të drejtë Karl Poperi kur ka thënë që ata që mendojnë më së shumti janë edhe njerëzit më përgjegjës për gabimet dhe mashtrimet e mëdha?***

Kolakovski: Paj, sipas këtij qëndrimi, del që mendimi është i pasigurt. Ndoshta edhe është ashtu, por ne jemi njerëz falë mendimit. Çfarëdo që të mendojmë, janë dy anë dhe njëra prej tyre nuk është e sigurt. Gjithashtu, qëndron që mendimtarët e mëdhenj janë edhe autorë të humbjeve a dështimeve të mëdha: Erazmo, Ruso, Hegeli, Marksi. Për përgjegjësinë mund të flitet kur janë të parashikueshme pasojat a konsekuencat e mendimit tonë. Rëndom ato nuk janë.

**** Në botën e sotme fuqia e njeriut është shtuar në të gjitha lëmenjtë. Në anën tjetër, nuk ka ligj i cili mund të na mbrojë prej vetvetes. Një pyetje duket e pashmangshme: A kanë dalë jashtë kontrollit problemet me të cilat po ballafaqohemi?***

Kolakovski: Me siguri që janë të bashkëlindura me ne gatishmëria për agresion, për dhunë, dhe afërsia me dhunën. Me gjasë, ky tipar i njeriut ka qenë i pashmangshëm apo parakusht për mbijetesën e llojit njerëzor. Këtu, si edhe në të gjitha çështjet tjera njerëzore, ne hetojmë dy anë të njëmendësisë. Agresioni e lind të keqen, por ne, njerëzit, arrijmë të njohim të keqen si të keqe, të cilën gjë asnjë gjallesë tjetër nuk arrin. Në këtë mënyrë ne disi arrijmë ta limitojmë agresivitetin tonë. Këtu nuk kemi të bëjmë me një ballafaqim midis natyrës dhe kulturës, sepse edhe kultura është bërë pjesë përbërëse e natyrës.

**** Alber Kamy ka shkruar që e vërteta është enigmatike, e paarritshme, që atë prore duhet pushtuar. Edhe për lirinë ai ka folur në të njëjtën mënyrë: Liria është e rrezikshme, është e vështirë të jetohet me te, por edhe më rrezik është të jetohet pa te...***

Kolakovski: Nevoja për siguri dhe nevoja për liri janë nevoja elementare për njeriun, por ato shpeshherë janë në konflikt: ndodhë që njërën prej tyre duhet ta kufizojmë, për ta siguruar të tjetrën. Të ashtuquajturat vlera në botën njerëzore janë në raporte të vazhdueshme konflikti dhe kështu do të jetë gjithnjë. Nuk ka botë në të cilën do të mund njëkohësisht të realizohen të gjitha nevojat tona dhe të gjitha të mirat.

**** Pikërisht ju në një rast keni shkruar që jeta jonë tani është***

Leshek Kolakovski

shumë më e lehtë, më e mirë se sa e paraardhësve tanë tre shekuj më parë. Por, gjithashtu keni theksuar që nuk kemi dëshmi që sasia e të keqes është zvogëluar tok me gjithë këtë përparim të madh. A mund të shpjegohet ky fakt disi?

Kolakovski: Në esencë, nuk mund ta masim sasinë e të keqes, megjithëse shpeshherë na duket që tash ka të keqe më shumë se përpara, për shkak të sasisë të informatave që i marrim. Teknika e prodhimit të së keqes, me siguri është përsosur në ndërkohë. Por kjo nuk do të thotë që njerëzit janë gjithnjë e më të këqij.

**** Po si shpjegoni ju faktin që njerëzit e sotëm, në vrapin e tyre për fitim dhe mirëqenie, harrojnë disi vlerat dhe qëllimet e jetës?***

Kolakovski: Kështu prore është folur në kuadër të moralit të krishterë. Neve na duket që gjithë kjo mësymje është diç e re, por mua më duket që nuk është ashtu. Na duket që dëshira për të pasur sa më shumë nuk ka kufi, por nuk e dimë se a ka qenë prore kështu, apo vetëm kohëve të fundit jemi bërë të tillë.

**** A është Historia mësuese e jetës? A është edhe sot e kësaj dite në fuqi pohimi i Hegelit që historia nuk ma mëson shumëçka? A ka ligjshmëri në histori fare?***

Kolakovski: Jam i sigurt që nuk ka ligje të historisë dhe që ngjarjet më të rëndësishme janë vepër e rrethanave të paparashikueshme. Por kjo nuk do të thotë që ne nuk duhet ta studiojmë historinë.

**** Gjatë shekullit XX demokracia në Evropë kurrë nuk ka qenë në gjendje të mbrohet nga diktuara para se të binin viktimat njerëzore. Si mund të shpjegohet fakti që të gjitha demokracitë bashkëkohore janë krijuar në këtë pjesë të botës?***

Kolakovski: Demokracia si bashkim i institucioneve të cilat na mundësojnë që t'i kanalizojmë dhe t'i zgjedhim problemet është një rezultat i qytetërimit evropian, i historisë evropiane. Shpeshherë citoj deklaratën e drejtë të Çërçillit, që demokracia vërtet është një sistem i keq, por të gjitha sistemet tjera janë më të këqija se demokracia. ■